

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Objekti i prokurimit : Sherbim i ruajtjes me roje private i objektit te DSHP Kavaje .

Kohe zgjatja: 10 muaj

Operatori ekonomik duhet te kete :

-Personel te licensuar me lejet perkatese te leshuar nga Drejtoria e Policise se Qarkut ku operatori ushtron aktivitet konform Ligjit Nr 75/2014 date 10.07.2014 "Per Sherbimin e ruajtjes dhe te sigurise fizike"

-Te jene te paisur me uniforme te rregullt ku te jene reklamuar dhe stema e shoqerise, -
Te jene te paisur me kartën e identitetit personal.

- Te jene te paisur me arme brezi.

-Te jene te paisur me mjete komunikimi.

-Te kete liber per marrjen e dorezimin e sherbimit.

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

Sherbim i ruajtjes me roje private te objektit te Drejtorise se Shendetit Publik Kavaje ,duke siguruar dhe ruajtur ambjentet ku ushtrohet veprimtaria dhe aktiviteti i DSHP Kavaje nga demtimet,vjedhjet e mundeshme.

-Numri i vendrojeve 1

-Numri i rojeve per nje vendroje 4 roje

-Koha e sherbimit: -Nga e hena deri te premten sherbimi do te kryhet ne turnin e dyte dhe te trete.

-Te shtune ,te diel dhe festa sherbimi do te kryhet ne tre turne.

Afatet e ekzekutimit:

Ekzekutimi i kontrates do te filloje nga data e lidhjes se kontrates e do te vazhdoje deri me 31.12.2017.

Rojet private do te qendrojne ne vendroje pa u larguar per gjithe periudhen e sherbimit duke mos lene vendsherbimin ne asnje moment pa roje.

TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Sherbim i ruajtjes me roje private te objektit te Drejtorise se Shendetit Publik Kavaje ,duke siguruar dhe ruajtur ambjentet ku ushtrohet veprimtaria dhe aktiviteti i DSHP nga demtimet,vjedhjet e mundeshme.

Detyrat:

- Ruajtja e objektit te DSHP nga vjedhjet e ndryshme qe mund te ndodhin dhe garantimi i rendit rregullit dhe qetesise mbrenda territorit te godines nen ruajtje.
- Rojet private do te qendrojne ne vendroje pa u larguar per gjithe periudhen e sherbimit duke mos lene vendsherbimin ne asnje moment pa roje.
- Rojet ne detyre duhet te jene te paisur me mjet nderlidhje ,te jene te paisur me uniforme me siglen dalluese te shoqerise dhe dokumenta qe vertetojne identitetin e tyre.
- Rojet duhet te kontrollojne masat e sigurise se objektit si rrethimin,ndricimin e per cdo parregullsi te informoje me shkrim pergjegjesin e rojeve dhe Drejtorine e DSHP Kavaje.
- Te kerkoje nga shtetasit dhe punonjesit qe te zbatojne rregulloren e brendeshme te objektit .
- Te mos lejoj parkimin e automjeteve te personave te huaj ne territorin e objektit ku kryen sherbimin.
- Roja i objektit per kryerjen e detyrave te tij bashkepunon me policine e rendit.
- Roja duhet te jete korrekt ne zbatimin e grafikut te sherbimit e te paraqitet 15 minuta para me qellim marrjen ne dorezim te sherbimit.
- Rojet e sherbimit duhet te plotesojne librin e dorezimit te sherbimit .Para marrjes se sherbimit ai duhet te kontrolloje objektin ne prezence te rojes dorezuese dhe per crregullimet e konstatuara njofton pergjegjesin e rojeve duke bere dhe shenimet perkatese ne librin e sherbimeve.
- Ndalohet ndërrimi i grafikut të shërbimit pa miratimin e përgjegjësit të rojeve.
- Shoqëria duhet të marrë përsipër zhdëmtimin 100% të dëmeve që vijnë për shkak të mos kryerjes si duhet të shërbimit nga punonjësit e shoqërisë.

Në vend-roje duhet të gjenden këto dokumenta:

- Libri i marrjes në dorëzim të shërbimit;
- Grafiku i shërbimit;
- Inventari i materialeve që ndodhen në objekt;
- Mjete ndriçimi në rast mungese energjije elektrike;
- Numrat telefonik të rajoneve të policisë, zjarrëfikseve dhe të personave kryesorë të DSHP Kavaje;
- Skemën e njoftimi në rast sulmi ose zjarri në objekt;

Shpërndarja:

-Numri i vendrojeve 1

-Numri i rojeve për një vendroje 4 roje

-Koha e shërbimit: -Nga e hëna deri të premtën shërbimi do të kryhet në turnin e dytë dhe të tretë.

-Te shtunë ,te diel dhe festa shërbimi do të kryhet në tre turne

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Objekti i DSHP Kavaje ,Adresa : Rruga” Jurgen Trade”, Lagjia nr 3, Kavaje.

Public Health Sector